



Raport Muaji Mars 2024

Informacion bazë

Administrimi i Fondit	Shoqëria Raiffeisen Invest sh.a
Monedha	Euro
Datë Lancimi	22 Nentor 2012
Vlera fillestare e kuotës	100
Shuma fillestare minimale	250
Shuma minimale pasuese	50

Komisione dhe Tarifa

Tarifë në hyrje	0.00%
Tarifë në dalje	0.00%
Tarifë Administrimi në vit	Deri ne 1.30% e vleres neto te aseteve

Tarifa te tjera te vazhdueshme **Referojuni prospektit te fondit**

Komisione/tarifa të vazhdueshme **1.50% per vitin 2023**

Kosto për transfertë fondesh nga palë të treta **Referojuni informacionit ne deget e RBAL**

Objektivi i investimit dhe profili i investitorit

Objektivi i Fondit është të mund t'i sigurojë investitorit një kthim nga investimi në perputhje me një menaxhim të kujdesshëm të portofolit duke ruajtur nivelin e kapitalit dhe likuiditetit të nevojshëm.

Nje pjese e rendesishme e asetete te fondit mund te investohen ne bono dhe obligacione thesari te Qeverise se Republikes se Shqiperise, te emtuara ne monedhen euro. Megjithate, frekuenca e emetimeve ne euro nga Qeveria e Republikes se Shqiperise do te percaktoje shkallen ne te cilen Fondi do te investoje ne keto lloj instrumentash.

Fondi eshte i pershtatshem per individe dhe subjekte juridike te cilet mendojne se objektivi i investimit i Fondit perputhet me kerkesat dhe pritshmerite e tyre.

Shifra e tarifave të vazhdueshme 1.50% mbështetet në shpenzimet për vitin e mbyllur më 31.12.2023. Kjo shifër mund të ndryshojë nga viti në vit. Tarifa totale e vazhdueshme nuk mund të kalojë maksimumin prej 1.6% ne vit te vlerës neto të asetete te fondit.

Kostot e transaksioneve janë sipas kushteve të punës të palëvendërmjetësuese dhe nuk përfshihen në llogaritjen e komisioneve dhe tarifave të vazhdueshme, por ato i ngarkohen Fondit.

Profili i Riskut dhe Përfitimit

Risk i ulët Risk i lartë
Përfitimet tipike më të ulëta Përfitimet tipike më të larta



Fondi Raiffeisen Invest Euro është në kategorinë e tretë të Profilit të Riskut dhe Përfitimit

Treguesi i riskut dhe përfitimit korrespondon me një numër të plotë i cili përdoret për të renditur fondin në një nivel risku nga 1 në 7, sipas nivelit të rritjes të luhatshmërisë. Kategoria më e ulët nuk do të thotë që investimi në fond është pa risk.

Ky tregues ka për qëllim tju informoje mbi luhatshmërinë e çmimit të kuotës së fondit bazuar në historikun e performancës së fondit. Të dhënat historike të përdorura për llogaritjen e treguesit nuk mund të përbëjnë një siguri të plotë për profilin e riskut në të ardhmen.

Të dhëna për Fondin në 31 Mars 2024


Vlerë Netë e Aseteve	32,540,761
Numri i Investitoreve	1,457
Cmimi i Kuotes	111.7062
*Kthimi Vjetor nga Investimi (31.03.2023 – 31.03.2024)	4.50%

*Tarifa e administrimit dhe tarifat e tjera të vazhdueshme zbriten përpara llogaritjes së kthimit nga investimi.

Struktura e Portofolit të investimeve më 31 Mars 2024

Portofoli i fondit Euro është ndërtuar në një mënyrë të tillë që të përfitojë nga balancimi i kategorive të ndryshme të investimeve në bono dhe obligacioneve qeveritare dhe të korporatave. Kjo bëhet me qëllim për të diversifikuar portofolin dhe ulur riskun që vjen nga ekspozimi i gjere ndaj pak instrumenteve.

Përqindja e alokimit të asetëve bëhet në përputhje me politikën e investimit dhe kriteret e specifikuar në prospektin e fondit. Shpërndarja e asetëve mund të jetë jashtë objektivit të përcaktuar për shkak të ndryshimeve të kushteve të tregut. Asetet e Fondit janë të investuara në instrumente financiare që i përkasin emetuesve që performojnë në industri të ndryshme të ekonomisë duke bërë të mundur rritjen e diversifikimit të portofolit.



Duke iu referuar strukturës së portofolit të investimeve të fondit më 31 Mars 2024, përqindja e asetëve të fondit e investuar në Obligacione Shtetërore ka pësuar rënie në 59.2% të asetëve dhe 47.1% i përkasin obligacioneve të emtuara nga Qeveria Shqiptare. Fondi mund të balancojë ekspozimin ndaj instrumenteve të ndryshme në varësi të kushteve të tregut për të arritur objektivat e tij afatgjatë. Asetet e fondit të investuara në obligacione korporatash dhe fondet investimesh me vlerësim të lartë përbëjnë 42% të totalit të aktiveve. Keto fonde investimi gjithashtu kanë në fokus investime në tregun e obligacioneve. Likuiditeti i mbajtur në cash dhe depozita është rritur në nivelin 5% e totalit të asetëve të fondit.

Vlera netë e asetëve të fondit është në nivelin 32.54 milionë EUR në fund të muajit mars.


Performanca e fondit dhe ecuria e çmimit të kuotës gjatë muajit Mars

Gjatë muajit mars cmimi i kuotes ka pësuar rritje me **0.31%**.

Shifrat zhgënjyese të inflacionit dhe perspektiva e vonuar e uljes së normave nga Bankat Qendrore sollën kthime të paqëndrueshme për obligacionet gjatë muajit. Megjithatë, ditët e fundit rezultuan në një rënie të përgjithshme të yield-eve, pasi Bankat Qendrore duken të vendosura të fillojnë uljen e normave këtë vit, megjithëse momenti i saktë mbetet i paqartë.


Si rezultat, zhvillimi i yield-eve të marsit pati një ndikim pozitiv në portofolin e investimeve të fondit Invest Euro, i cili rezultoi me fitim gjatë këtij muaji. **Kthimi neto vjetor i fondit është +4.50% më 31 Mars 2024.**

Ecuria e performancës së Fondit Raiffeisen Invest Euro



Ne dt 31 Mars 2024	1 Vit	3 Vite	5 Vite	8 Vite	10 Vite	Nga lancimi (22 Nentor 2012)
Kthimi ne % p.a per periudhen	+4.50%	-1.59%	-0.98%	+0.03%	+0.64%	0.98%

Kthimi Neto i fondit Raiffeisen Invest Euro per çdo vit



Duhet patur parasysh se norma e kthimit ndryshon ne varesi te kushteve te tregut dhe çmimi i kuotës mund të jetë i luhatsëm, pra nuk është statik apo gjithmonë në rritje, por edhe mund të bjerë si pasojë e ndryshimeve të kushteve në treg. Luhatshmëria është pjesë e natyrshme e fondeve te investimit dhe eliminimi total i saj është i pamundur.

Investitoret e fondit Raiffeisen Invest Euro dhe te gjithe fondeve te administruara nga Raiffeisen Invest keshillohen te kene nje horizont sa me te gjate investimi per te perfituar nje kthim optimal nga investimi dhe ne kete menyre ne periudhe afatmesme apo afatgjate te kene mundesi te rikuperojne edhe efektet negative te krijuara afatshkurter.

Investitoret inkurajohen qe te ruajne investimin e tyre duke mos ndryshuar objektivin e qendrimit ne fond te nxitur nga situata jo e zakonshme e krijuar nga pandemia globale, sepse ne kete menyre nuk do te riskojne te dalin nga fondi ne momentin e gabuar per investimin e tyre.

Zhvillimet dhe informacion mbi ecurinë e tregjeve financiare gjate muajit Mars

Inflacioni në zonën e euros të përbërë nga 20 shtete u lehtësua në nivelin 2.4% në mars, duke rritur pritshmëritë për uljen e normave të interesit në verë. Ekonomistët e anketuar nga Reuters kishin parashikuar se norma do të qëndronte e palëvizur nga muaji i kaluar në nivelin 2.6%. Norma bazë e inflacionit, duke përfshirë energjinë, ushqimin, alkoolin dhe duhanin, u ul nga 3.1% në 2.9%, gjithashtu nën pritshmëritë.

Inflacioni u rrit përsëri në shkurt, duke e shtyrë Rezervën Federale të presë të paktën deri në verë përpara se të fillojë të ulë normat e interesit. Indeksi i çmimeve të konsumit u rrit me 3.2% nga një vit më parë, pak mbi konsensusin. CPI bazë u rrit me 3.8% në vit, rreth 0.1% më lart se parashikimi.

Zyrtarët e Rezervës Federale ruajtën perspektivën e tyre për uljen e normave me 0.75% këtë vit, por parashikimet e reja tregojnë më pak ulje për vitin 2025, si pasojë e rritjes së fundit të inflacionit. Zyrtarët vendosën njëzëri të lënë normën bazë të fondeve federale në një interval prej 5.25% - 5.5%, më e larta që nga viti 2001, për një takim të pestë radhazi.

Presidentja e Bankës Qendrore Evropiane Christine Lagarde theksoi se politikëbërësit mund të jenë në gjendje të ulin normat e interesit në qershor, pasi parashikimet e reja treguan se inflacioni arrin objektivin prej 2% në 2025. Duke folur pasi politikëbërësit e lanë normën e depozitave në 4% për një takim të katërt radhazi, Lagarde tha se ka një ngadalësim të caktuar të çmimeve të konsumit, por ajo dhe kolegët e saj nuk janë "mjaf tueshëm të sigurt" aktualisht për të filluar lehtësimin monetar.

Tregjet e obligacioneve përjetuan një muaj të paqëndrueshëm, për shkak të shifrave zhgënjyese të inflacionit dhe perspektivës së vonuar të uljes së normave nga bankat qendrore. Megjithatë, ditët e fundit sollën një rënie të përgjithshme të yield-eve, pasi bankat qendrore duken të vendosura të fillojnë uljen e normave këtë vit, megjithëse momenti i saktë mbetet i paqartë. Obligacionet e qeveritare u rritën me 0.7% dhe yield-et më afatgjata pësuan rënie, por shumica e kthimeve të obligacioneve sovraane mbetën negative për këtë tremujor.

Të dhënat e kthimit nga investimi në të shkuarën janë vetëm ilustrative dhe nuk përfaqësojnë një premtim apo garanci për kthimin në të ardhmen. Të gjithë shembujt e tjerë numerikë janë përdorur për qëllime ilustrative dhe analizë të të dhënave historike, dhe nuk duhen përdorur nga investitorët për të nxjerrë konkluzione për të ardhmen. Investitorët e mundshëm duhet të lexojnë Prospektin dhe Rregullat e Fondit. Raiffeisen Invest dhe forca shitëse e fondit nuk garantojnë një kthim të caktuar të fondit.

Informacioni mbi çmimin e përditësuar të kuotës, prospektin dhe rregullat e Fondit gjendet pranë zyrave të Raiffeisen Invest sha., në faqen zyrtare www.raiffeisen-invest.al ose në degët e Raiffeisen Bank në Shqipëri.